



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Data 14.07.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: *Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të
varfera dhe të pafavorizuara.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): - 45211200-1
Punime ndërtimi për shtëpi strehimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 38,386,238 *(tridhjetë e tetë milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë
mijë e dyqind e tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh.*

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.
Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **19,193,119** (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tremijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **76,772,476** (shtatëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9(*Formulari i vleresimit*), shoqëruar me:

- *Kontrate;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Aktin e kolaudimit*
- *Fatura tatimore.*
- *Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtem:

- *Kontrate;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Akt kolaudimi;*
- *Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.*
- *Faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore.*

Pika **2.3.1 gërma a** plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për kontratat e realizuara si **Bashkim Operatorësh**, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si **Nenkontraktor**, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontrata baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **19,193,119** (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tremijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **76,772,476** (shtatëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë

teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë** burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: “**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P – 3 B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008 (i ndryshuar)). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

- N.P – 3 B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me rikonstrukcion mirëmbajtjeve të shtëpive të familjeve ne nevojë ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje catie ekzistuese, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NS-1A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me veshje fasade veshje tavani, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NS-4 A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërise, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm;

- a) Kontratë pune noteriale
- b) Diplomë
- c) CV

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për

ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4.Operatori ekonomik duhet të kete nje punesim mesatar minimumi **34(tridhjetë e katër)** punonjes (bashke me stafin Teknik)te vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi **për 3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjese, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **34 punonjësish**, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **140 dite pune** nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Afati 140 ditë

Sasia e orëve të punës sipas manualit është 38080:8:140=**34 punonjës me gjithë stafin**

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierin e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierin e kërkuar, si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.6. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve në objektin e kontratës, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar me arsim të lartë dhe të mesëm si staf mbështetës. Specialistet të shoqërohen me kontrata pune, diplome/ certifikate, Certifikate të vlefshme të sigurimit teknik, të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Teknik Ndërtimi

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për specialistet, emer/mbiemer, profilin e punës, datën e kontratës individuale të punës, numrin e certifikatës profesionale si dhe institucionin privat ose shtetëror që e ka lëshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e

autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, specialist i kërkuar është në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohej që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në specifikimet teknike.

2.3.7.Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes te specializuar/kualifikuar si me poshte:

2 (dy)	Hidroizolues
1 (një)	Termoizolues
2 (dy)	Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm
2 (dy)	Punonjës për veshje fasade (sistemi kapot))
2 (dy)	Punonjës duro-alumini
4 (katër)	Karpentjer
1 (një)	Saldator
2 (dy)	Suvatues
2 (dy)	Bojaxhi
2 (dy)	Pllakashtrues
1 (një)	Betonues dhe të tjerë që lidhen me to
3 (tre)	Shoferë
1 (një)	Automakinist
6 (gjashtë)	Punëtorë

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Për punonjesit manovrator/shofer/automakinist ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Për punonjësit e specializuar të paraqitet dëshmi ose certifikatë kualifikimi nga një institucion i çrtifikuar
- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere/Ekskavatorist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- d) Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar.

Në rastin kur punonjësit Manovratorë/Automakinistë ose shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga organe kompetente .

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshetje te VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"*.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **2 (dy) Hidroizolues** nevojiten për kryerjen e punimeve hidroizoluese marë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
- **1 (një) termoizolues** nevojitet për kryerjen e punimeve termoizoluese duke marë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.

- **2 (dy) Përgatitës të konstruksioneve metalike** dhe të ngjashëm nevojitet për kryerjen e punimeve tkonstruksione metalike duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
- **2 (dy) Punonjës për veshje fasade (sistemi kapot),** nevojiten për kryerjen e punimeve të sistemit kapot, duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit..
- **2 (dy) Punonjës duro-alumini** duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit..
- **4 (katër) karpentier** nevojitet për kryerjen e punimeve karpentierie duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
- **1 (një) saldator** prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike
- **2 (dy) punonjes suvatues** nevojiten për kryerjen e punimeve të suvatimit duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
- **2 (dy) punonjes bojaxhi** nevojiten për kryerjen e punimeve të bojatisjes duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
- **2 (dy) punonjes pllakashtrues** nevojiten për kryerjen e punimeve të shtrimit të pllakave duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
- **1 (një) betonues dhe të tjerë që lidhen me to,** nevojitet për kryerjen e punimeve të betonimit, duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 520:8:65=1 punonjës
- **6 (shtatë) punëtorë** nevojiten për kryerjen e punimeve të ndryshme në vartësi të specialistëve të ndërtimit dhe punëve të ndryshme në kantier sipas zërave të preventivit.
- **3 (tre) shofere** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike
- **1 (një) Automakinist** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për **për 3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjese

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.9. Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:
- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ne pune **ISO 45001-2018/45001-2023**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “D” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe ne zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të

ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.10. Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri*”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si*

grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.11. Operatori Ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 12 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçina me kapacitet 1-5 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
3	Minifadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
4	Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Depozitë Uji ≥ 1000 litra	2 copë	Në pronësi ose me qira
6	Pompë suvatimi	1 copë	Në pronësi ose me qira
7	Skeleri + platforma + rrjetë mbrojtëse	1000 m ²	Në pronësi ose me qira
8	Motobetonierë 0.5m ³	4 copë	Në pronësi ose me qira
9	Nivelues/Helikopter betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
10	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qira
11	Vinç elektrik me karel deri 0.5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
12	Gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qira
13	Saldatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qira
14	Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qira

Mjete dhe paisje të mbrojtëse në punë:

- Kokore mbrojtëse 34 copë
- Jelekë 34 copë
- Fikse Zjarri 3 copë
- Tabela Sigurimi Teknik 20 copë
- Kutitë (komplet) e Ndhmës së shpejtë 3 copë

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) çertifikatë transporti

Kur janë me qira, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;

- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) certifikatë transporti

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.
1. ***Kamioni, kamionçinat, autovinç, platformë vinçi me kosh, helikopteri nivelues dhe pajisjet e tjera ndihmëse janë kërkuar për kryerjen e punimeve më të transportit të materialeve për në kantiere në përputhje me zërat dhe volume e preventivit ;***
 2. ***Autobetonierë, pompë suvatimi, betonierë, vibrator betoni dhe depozita uji janë kërkuar në përputhje me zërat dhe volume e preventivit si mure , shtresa betony, suvatime shtrim pllakash etj.***
 3. ***Skeleri 1000m² janë kërkuar në përputhje me zërat dhe volume e preventivit për ndërtimin mureve dhe punimet e tjera fasadë etj ;***

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Njesia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia përgjegjëse në specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim

favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT: